



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**

**NJOFTIM PËR POZICIONIN “ANËTAR PRANË KOMISIONIT TË PROVIMEVE TË
AFTËSIVE PROFESIONALE (KPAP)”**

Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*”, i ndryshuar, për të realizuar testimet, në kuadrin e provimeve përfundimtare të aftësive profesionale për marrjen e titullit Kontabilist i Miratuar dhe Auditues Ligjor, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) ngrihet dhe funksionon Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP).

KPAP përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga BMP për një periudhë katër vjeçare, sipas

propozimeve të mëposhtme:

- a) kryetari nga Ministri i Financave;
- b) dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- c) një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- ç) një anëtar nga profesori i fushës së universiteteve.

Në zbatim të pikës 2 të nenit të sipërcituar, si dhe në përputhje me Rregulloren nr. 2, datë 22.02.2018 “*Për funksionimin e komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar*” e ndryshuar, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, kandidatët e propozuar duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

1. Duhet të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të cilat duhet të jenë të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën, me përvojë profesionale jo më të vogël se 10 (dhjetë) vite, ose 7 (shtatë) vite përvojë pune, në rast se mbajnë një grade apo titull shkencor. Gjithashtu, përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2 të këtij neni duhet të:
 - a) jenë shtetas shqiptarë;
 - b) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
 - c) të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo strukturat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së komisionit;
 - ç) të mos jenë të angazhuar në role apo funksione politike;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

d) të mos jenë në strukturat/këshillat drejtuese të më shumë se një nga organet/institucionet/organizatat e parashikuara në ligjin 10091/2009 që lidhen drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me përzgjedhjen dhe veprimtarinë e KPAP.

2. Përveç kritereve të mësipërme do të konsiderohen preferenciale kriteret e mëposhtme:

a) të kenë eksperiencë në ligjërime apo trajnime profesionale në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe financës;

b) të kenë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore së paku në 5 vitet e fundit në fushën e auditimit, kontabiliteti dhe financës.

Përfaqësuesit e parashikuar në germat b) dhe c) aplikojnë pranë institucioneve përkatëse, dhe propozimet shoqëruar me dokumentacionin përkatës si dhe lista e plotë e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar pranë organizatave profesionale, dorëzohen pranë BMP. Përfaqësuesit e parashikuar në germën ç) aplikojnë drejtpërdrejtë pranë BMP.

Për sa më sipër, propozimet përkatëse me dokumentacionin shoqërues duhet të dorëzohen pranë BMP brenda datës 15 Nëntor 2024.

Duke ju falenderuar,
Bordi i Mbikëqyrjes Publike